REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
KESHILLI BASHKISE DEVOLL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 64, Date 22 / 10 /2025

"Per miratimin e kerkeses se Bashkise Devoll se bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor per akordimin e ndihmes financiare per familjen e Z. Gëzim Bono , banues ne fshatin Pilur , Njesia Administrative Progër , banesa e te cilit eshte djegur plotesisht si rezultat i nje shkendije elektrike ne banesen e tij.

BAZA LIGJORE

Ligji Nr. 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore",
Ligjin Nr. 107./2016 "Per Prefektin"
Ligjit Nr. 45/.2019"Per Emergjencat Civile".
VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerzore"

PROPOZOJ:

1- Te miratoje mbeshtetjen financiare per familjen **Z.Gëzim Bono** per demtimin e baneses si pasoje e renies se zjarrit

3-Te miratoje masen e demit financiar te kesaj familje ne vleren totale eshte **715141(shtateqind e pesembedhjete mije e njeqinde dyzet e nje) lek**.

Kjo vlere do te perballohet nga fondi i Emergjencave Civile dhe Bashkise i destinuar dhe i miratuar nga Keshilli i Bashkise Devoll nga Buxheti i vitit 2025.

4-Ndihma financiare qe do te akordohet do te perdoret per ti ardhur ne ndihme familjes se shtetasit **Z Gëzim Bono** banesa e te cileve eshte e djegur plotesisht si pasoje e zjarrit te ne daten 04.10.2025.

5- *Per zbatimin e ketij urdheri ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Sektori i Planifikimit te Buxhetit..*

Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6 e ligjit 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore".

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PERGJEGJESI
Yllson STENA

SEKTORI JURIDIK

PERGJEGJESI
Eriksela AVDO

KRYETARI I BASHKISË

EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE DHE MBROJTJES SE TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr 3204 prot

Bilisht me 06/10/**2025**

URDHER

Nr 526 **Date** 06 / 10 / **2025**

"Per ngritjen e komisionit te konstatimit dhe te vleresimit te gjendjes per demet e shkaktuara nga fatkeqesia natyrore

Bazuar ne Ligjin Nr.145/2019 "Per Mbrojtjen Civile", VKM Nr.329 date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerzore.

URDHEROJ:

1-Te ngrihet komisioni i Konstatimiti cili te konstatoje demet ne banesen e Z.Gezim Bono banues ne fshatin Pilur,njesia Ad.Proger, Bashkia Devoll banesa ete cilit eshte djegur nga renia e zjarrit me dt.04.10.2025.
2-Ne perberje te Komisionit te Konstatimit te gjendjes per demet e shkaktuara nga zjarri, te jene personat e meposhtem:

1.Yllson Stena Pergjegjes Emergjencat Civile
2-Valbona Beshi Specialist Inxhinier ne sektorin e IVMT
3-Florenc Shpuza Specialist Emergjencat Civile

3-Te ngrihet komisioni i Vleresimiti cili te vleresoje demet ne banesen e Z.Gezim Bono, banues ne fshatin Pilur Njesia Ad.Proger,Bashkia Devoll banesa e te cilit eshte djegur plotesisht nga renia e zjarrit me dt 04.10.2025
4-Ne perberje te Komisionit te Vleresimit te gjendjes per demet e shkaktuara nga ky zjarr te jene personat e meposhtem:

1-Esiona Meka Specialiste Inxhinjere Ndertimi
2-Joni Serti Specialist Emergjencat Civile
3-Erjon Rado Pergjegjes i Kadastres dhe Inventarizimit te Aseteve

Per te gjitha konstatimet dhe vleresimet ne vendngjarje komisioni te hartoje proces-verbalin i cili duhet te perfundoje brenda 5 diteve nga ngritja e ketij Urdheri
Ky urdher hyn ne fuqi menjehere

KRYETARI I BASHKISE
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPERISË BASHKIA DEVOLL

Adresa: Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9; Tel+355811222888; E-mail; bashkiadevoll@gmail.com; web: http://bashkiadevoll.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SE TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Bilisht 06.10 .2025

PROCES-VERBAL KONSTATIMI

I mbajtur sot me date 06.10.2025 , nga Komisioni i Konstatimit i ngritur me **Urdherin Nr 526 dt 06.10.2025** i perbere nga :

1-Yllson Stena (Pergjegjes i Emergjencave.Civile)

2-Vabona Beshi (Specialist Inxhinier ne sektorin e IVMT)

3- Florenc Shpuza (Specialist i Sektorit te Emergjencave Civile)

Komisioni i ngritur per verifikimin e demeve te shkaktuara si pasoje e rrenies se zjarrit per shkak te nje shkendije elektrike ne shtepine e Z.Gëzim Bono i cili eshte , banues ne Fshatin Pilur Njesia Administrative Progër konstatoi se :

1-Banesa e Z.Gëzim Bono si pasoje e renies se zjarrit ,ju shkaktuan deme te konsiderueshme.

2-Per shkak te ketij zjarri objekti eshte i pabanueshem.

3-Komisioni beri konstatimin dhe vleresimin konform *Ligjit Nr.45/2019 "Per mbrojtjen Civile" Neni 30 pika gj , "Bashkite kryejne vlersimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesite ne territorin e tyre, vlersimin e nevojve per perballimin e tyre, si dhe demshperblejne shtetasit per fatkeqesine e ndodhur ne territorin e tyre",Vendimit Nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesite natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerzore".*

1- Pershkrimi i objektit;
Banesa eshte , nje kat me bodrum , ndertim me murature guri , tulle dhe plithar ,cati vendi mbulesa me tjegulla.
Objekti ka nje hyrje .Shtëpia e tipit Elbasance (Në forme L) .Catia ka qene e ndertuar me materjal druri dhe mbulese me tjegulla si dhe tavane me materjale te lehta dhe nderkati pjeserisht me dru.
Çatia është djegur tërësisht .

Pershkrimi i demit ne objekt ne te cilen kishte rene zjarri:
Demet:

Cati e djegur plotesisht me nje siperfaqe rreth	90 m2
Tavane te djegura plotesisht rreth	130 m2
Dyert te jashtme te djegura ne siperfaqen rreth	2.3 m2
Dyert te brendeshme te djegura ne siperfaqen rreth	8.2 m2
Dritare te djegura	7.8 m2
Riparim suvaje e brendeshme dhe lyerje me boje	257 m2
Nderkat druri	60 m2

Shtepia e Z. Gëzim Bono nuk ka dokumenta pronesie pasi I janë djegur .
Vlera e demit ne preventivin shoqerues.
Orendite e brendeshme te djegura:

1- Frigorifer 2 cop
2-Lavatrice 1 cop
3-Divane 4 cop
4-Bufe 1cop
5-Karrige 15 cop.
6 -Dollap rrobash 1 cop
7 – Dysheg dopio 1 cop
8- Tapetë 3 cop
9- Batanie 10 cop
10-Carcafe 10 cop

KOMISIONI I KONSTATIMIT :

1.Yllson Stena Përgjegjës Emergjencat Civile
2-Valbona Beshi Specialist Inxhinier ne sektorin e TVMT.
3. Florenc Shpuza Specialist Emergjencave Civile

KRYETARI I BASHKISE

Eduard DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE DHE MBROJTJES SE TERRITORIT

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Bilisht me ___/___/2025

Preventivi i demeve ne orendi dhe paisje te shkaktuara nga zjarri ne banesen e Z.Gezim Bono.

Nr	Emertimi i materialit	Njesia	sasia	Cmimi per njesi	Gjithesej
	Frigorifer	Cop	2	10500	21000
1	Lavatrice	Cop	1	23902	23902
2	Divane	Cop	4	11682	46728
3	Bufe	Cop	1	10248	10248
4	Karige	Cop	15	1500	22500
5	Dollap Robash	Cop	1	15667	15667
6	Dysheg dopio	Cop	1	13904	13904
7	Tapete	Cop	3	5127	15381
8	Batanije	Cop	10	1629	16290
9	Carcafe	Cop	10	1146	11460
	Shuma				197080

Çmimet e orendive dhe te paisjeve jane rereferuar te dhenave te Drejtorise se Pergjitheshme te Tatimeve me nr.29053/3 prot. Date 15.08.2016 dhe manualit te cmimeve te orendive viti 2023

Vlera e clyerjes te demit per orendite eshte 100% per Shumen 197080(njeqind e nentedhjete e shtate mije e tetedhjete) lek.

KOMISIONI

Ylison Stena **Florenc Shpuza** **Valbona Beshi**

MIRATOI

KRYETARI

Eduard Duro

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

`BASHKIA DEVOLL

KOMISIONI I VLERESIMIT

Bilisht me ___/___/2025

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot ne daten 10.10.2025 nga komisioni i vleresimit i ngritur me Urdherin e Kryetarit te Bashkise Nr 526 Date 06.10.2025 , i perbere nga :

1-Esjona Meka **2-Joni Serti** **3-Erjon Rado**

Komisioni I ngritur per vleresimin e demeve te shkaktuara nga zjarri ne banesen e **Z. Gezim Bono** banues ne fshatin Pilur, Njesia Administrative Proger vleresoi vleren e demeve sipas preventivit:

Nr.	Nr.An.	Emertimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2	3	4	5	6	7
1 - Punime Suvatimi dhe shtresash						
	2.310	Suva brenda mur tulle, llaç perzier	m2	257	633	162681
	293	Tavan res kallami+suva	m2	130	1911	248430
	279	Shtrese me derrase dysheme 2.5 cm +listela	m2	60	1575	94500
SHUMA 1						**505611**
2- punime dyer dritare						
	379	Dyer te brendeshme tamburato te thjeshta	m2	8.2	12382	101532.4
	379	Dyer te jashtme	m2	2.3	12382	28478.6
	An	F.V dritare druri	m2	7.8	7950	62010
SHUMA 2						**192021**
3-punime catie						
	218	Çati vendi HD~8m, mbuluar, tjegulla vendi	m2	90	3761	338490
SHUMA 3						**338490**
Shuma 1 +2+3						**1036122**

Shenim: Cmimet jane mbeshtetur ne VKM Nr.329 date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerzore

Vlera e shlyerjes se demit eshte 50% ne shumen **518 061 (Peseqind e tetembedhjete mije e gjashtedhjete e nje)** leke pa TVSH.

KOMISIONI :


Esjona Meka

Joni Serti

Erjon Rado

Bashkia Devoll,Lagjia nr.1 Rr. 24 Tetori nr. 9,Tel & Fax +355811123815-22288, E-mail bashkiadevoll@gmail.com.

PLANIMETRI E OBJEKTIT



FLETA	PLANIMETRI E OBJEKTIT
KOMISIONI	Esjona Meka Joni Serti Erjon Rado
SHKALLA	1:100

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SE TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 3384 **Prot.** **Bilisht me** 21 / 10 **/2025**

RELACION

Lenda: Miratimi mbi vlersimin e demeve nga ana ndertimore dhe demeve ne orendi per familjen e Z Gëzim Bono banues i fshatit Pilur Bashkia Devoll .

Drejtuar: Keshillit Bashkiak Devoll.

Ne daten 04.10.2025 banesa 1 kateshe me bodrum e shtetasit Gëzim Bono ne fshatin Pilur Nj.Administrative Progër u perfshi nga flaket e zjarrit dhe si rezultat me gjithe nderhyrjen e vete familjareve dhe banoreve te fshatit, Strukturave të Zjarfikses Devoll ,dhe Policisë objektit u dogj .

.Kryetari i Bashkise me Urdherin Nr. 526 date 06.10.2025 "Ngriti komisionin te Konstatimit dhe te Vleresimit te gjendjes per demet e shkaktuara nga fatkeqesia .

Konform ***Ligjit Nr.45/2019 "Per mbrojtjen Civile" Neni 30 pika gj , "Bashkite kryejne vlersimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesite ne territorin e tyre, vlersimin e nevojve per perballimin e tyre, si dhe demshperblejne shtetasit per fatkeqesine e ndodhur ne territorin e tyre", Vendimit Nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesite natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerzore".***

Nga ana e komisionit te Konstatimit eshte bere konstatimi i demeve ne banesen Z.Gëzim Bono banues ne fshatin Pilur ,Njesia Administrative Progër dhe nga ana e komisiont te Vleresimit eshte bere vleresimi i demeve dhe eshte mbajtur proces-verbali me te gjitha zerat sipas demeve te shkaktuara ne orendi dhe materiale dhe ne baze te proces-verbalit te vleresimit jane hartuar

preventivat me vleren e demit ne orendi dhe ne material ndertimi konform te gjitha akteve ligjore dhe nenligjore nga ana e specialisteve te Bashkise Devoll.

Ne baze te vleresimit te demeve nga ana e specialisteve te Bashkise Devoll i propozojme Keshillit te Bashkise Devoll dhenien e ndihmes financiare per materialet e ndertimit ne vleren sipas preventivit **1036122(nje million e etridhjete e gjashte mije e njeqind e njezet e dy)** lek i cili do te shperblehet ne masen 50% ,me **vleren 518061 (peseqind e tetembedhjete mije e gjashtedhjete e nje) leke.**Ndersa vlera e orendive eshte llogaritur sipas listes te Drejtorise te Pergjithshme te Tatimeve e cila shkon ne vleren prej **197080(njeqind e nentedhjete e shtate mije e tetedhjete**)lek.

Shuma e pergjitheshme qe do trajtohet familja e Gëzim Bono eshte **715141(shtateqind e pesembedhjete mije e njeqinde dyzet e nje) lek**.

Per zbatimin e ketij urdheri ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria e Sherbimeve Financiare dhe Sektori i Planifikimit te Buxhetit.

KOMISIONI I KONSTATIMIT

Yllson Stena

Valbona Beshi

Florenc Shpuza

KRYETARI
Eduard DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
AGJENCIA E INSPEKTIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI I MBROJTJESNGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Nr.3395Prot **Bilisht me 11.10.2025**

AKT-EKSPERTIMI NR 12

Mbi ekspertimin e zjarrit te rene ne fshatin Pilur .

Me adrese : Pilur Njesia Administrative Proger

Rrethi Devoll

Bashkia Devoll

Ne baze te vendimit date 05.10.2025 te Oficerit te Policise Gjyqesore prane Prokurorise se Rrethit, Z.Lulzim Preçi, per kryerjen e ekspertimit te zjarrit te rene ne fshatin Pilur mua Gentjan Xhafka, me cilesine e ekpertit te MZSH-se me kerkohet ti pergjigjem ketyre pyetjeve:

1. A mund te percaktohet vatra e zjarrit ne ngjarjen e pershkruar me lart dhe nese po, ku gjendet ajo?

2. Cili është shkaku I renies së zjarit?

Per ti dhene pergjigje ketyre pyetjeve u krye kqyrja e vendit te ngjarjes.

Pergjigjje e pyetjeve

Lidhur me pyetjen e shtruar prej jush se cila është vatra e zjarrit rënë ne datën 04 .10.2025 ju bejme me dije se vendi I ngjarjes ndodhet ne fshatin Pilur njesia administrative Proger , ku objekti I kqyrjes eshte banesa e shtetasit Gezim Bono banues ne fshatin Pilur te Rrethit Devoll.

Objekti I kqyrjes eshte shtepia e banimit te shtestasit Gezim Bono , e cila ishte nje katshe me bodrum (ne forme L Elbasance)

Nga kqyrja e afert rezulton se kati mbi bodrum eshte djegur plotesisht .

Zjarri ka filluar ne tavanin e koridorit ku kalonte teli me energji elektrike, ku si pasoje eshte edhe djegja me e madhe.

Nga tavani I koridorit zjarri esht perhapur me shpejtesi ne pjesen e catise e cila u dogj e gjitha dhe me pas si pasoje e shkeputjes se tavanit zjarri ka avancuar edhe ne pjeset e tjera te shtepise

Me pas zjarri eshte perhapur ne te gjitha dhomat dhe siperfaqen e baneses, ku nga flaket eshte perfshire e gjithe banesa .

Si pasoje e intesitetit te larte te zjarrit jane te djegur te gjitha orendite e ndryshme shtepiake te dhomave , po ashtu duke qene se dyshemeja e katit lart ishte prej ndruri beri qe zjarri te kalonte edhe ne pjesen e bodrumit , ku u dogj e gjithe dyshemeja dhe pjese te ndryshme dhe orendi shtepiake .

Gjithashtu flaket e shumta sollen renimin e plote te Catise si dhe te dyshemse te drurit te siperpermendur .

Pra ne perfundim themi se nga kqyrja e afert dhe nga analiza e te gjitha detajeve te vendit te ngjarjes vatra e zjarrit ndodhet ne Dhomen me drejtim perendimor dhe konkretisht ne rrjetin elektrik te kesaj dhome .

Ne pergjigje te pyetjes te dyte se Cili eshte shkaku I renies se zjarrit themi se ;

Nga kqyrja e afert e vendit te ngjarjes si dhe nga percaktimi I vatres se zjarrit mendohet se shkaku I renise se zjarrit eshte shkendija elektrike qe ndodhet ne dhomes qe pershkruam me lart.

Ne vendgjarje nuk u gjeten prova te tjerra si fije shkrepse, bombel gazi , mbetje te tjerra qe munnd te a coje ne nje perfundim tjeter per shkaun e renis se Zjarrit .

Komandanti I Stacionit

Arben Meka

Përgjegjësi I Sektorit të MZSH-se

Gentjan Xhafka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E SHËRBIMIT TË MZSH
SEKTORI
BASHKIA DEVOLL

Adresa: LagjaNr. 1, Rr. 24 Tetori, Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
AGJENCIA E INSPEKTIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI I MBROJTJA E ZJARRIT DHE SHPËTIMI

Nr. 3395 **Prot.** **Bilisht më,** 21/10 **/2025**

Lënda: Dërgim akt-ekspertimi

KOMISARIATI I POLICISE
DEVOLL
(Për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Korcë)

Në zbatim të vendimit të Prokurorisë e cila kërkon të përcaktohet vatra e zjarrit dhe shkaku I rënies së zjarrit, bashkëngjitur po ju dërgojmë ak-ekspertimin me të dhënat përkatëse.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR I BASHKISË
EDUARD DURO

Adresa: LagjaNr. 1, Rr. 24 Tetori, Nr. 5; Tel+35581122288; E-mail: bashkiadevoll@gmail.com; ëeb: http://bashkiadevoll.gov.al/

Nr. 3276 Prot
Dt 13.10.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DEVOLL
NJESIA ADMINISTRATIVE PROGER

Nr. 428 **Prot** **Progër, më** 06 . 10 **.2025**

LËNDA: KERKESE PER MARRJE SHERBIMI

BASHKISE DEVOLL

SEKTORIT TE EMERGJENCAVE CIVILE

PER DIJENI KRYETARIT Z. EDUARD DURO

Pas kerkeses te **z. Gezim Bono**, banues ne fshatin **Pilur** njesia administrative Proger, kerkojme nga ana juaj marjen e sherbimeve te nevojshme per kete familje.

- Fotokopje ID e z. Gezim Bono.
- Kerkese e z. Gezim Bono.

Ju lutemi merrni masa te menjehershme!

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

Punonjes i deleguar

Xhuljana Mekolli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË NJËSIA ADMINISTRATIVE PROGËR BASHKIA DEVOLL

KËRKESË

DREJTUAR: BASHKISË DEVOLL

Njesia administrative Progër
Zyra e Kërkesave dhe Ankesave

Emër Mbiemër: Z./Znj. Gezim Bano Nr. ID G.0801045N	**Vendbanimi:** Pilur **Adresa elektronike:** _____ **Nr. Tel:** _____	Data: 16/10/2025 Nënshkrimi:

Përshkrim i detajuar i kërkesës (plotësohet nga aplikanti)

Une i nenshkruari Gezim Bano banues ne Fshatin Pilur, kerkoj nga ana e Bashkise Devoll ndihme sepse banesa ime e perfshi nga ylaket dhe ka pesuar demtime te rendo per shkak te nje defekti elektrik te energjise elektrike. I Zjarri ka shkaterruar shkaktuar deme te rendo duke bere te pamundur qendrimin ne banesë. Per kete arsye jo lutem me ndihmoni.

Bashkëlidhur gjeni dokumentat e poshtëshënuara:

1) fotokopje ID e Z. Gezim Bano
2) _____
3) _____
4) _____

Plotësohet nga personi që pranon kërkesën

Specialisti që pranoi aplikimin	Afati i kthimpërgjigjes	Numri rendor i kërkesës
Xhuljana Fetoll	____.____.2025	_____

Banesa e djegur Fshati Pilur

04.10.2025

